

Çka duhet të dini rreth aplikimit të ripërtërjes së sigurimit shëndetësor Medicaid përmes Shëndetësisë së shtetit të Nju Jorkut nëse aksioni për shtyerjen e arritjes së fëmijëve është shfuqizuar.

1. Shfuqizimi i DACA (Veprim i Shtyrë për Ardhjen e Fëmijëve) nuk e ndryshon statusin PRUCOL që e ke për sigurimin shëndetësor Medicaid.

Në bazë të ligjit të shtetit të Nju Jorkut, personat me statusin e DACA-s dhe ata me statusin e shfuqizuar të DACA-s mund të jenë të pranueshëm për sigurimin shëndetësor Medicaid të financuar nga shteti në kategorinë e quajtur PRUCOL (permanently residing under color of law- banorë të përhershëm nën ngjyrën e ligjit).

2. Çfarë ju duhet për të ripërtërirë sigurimin shëndetësor Medicaid os të aplikoni nëse statusi i juaj DACA është shfuqizuar?

Thirrëni Shërbimin e Klientëve në këtë numër: **1-855-355-5777**, personat me vështirësi në të folur dhe dëgjim telefononi: **TTY: 1-800-662-1220** ose mund të takoheni personalisht me një ndihmës në komunitetin tuaj. Duhet t'ua bëni me dije përfaqësuesit ose ndihmësit tuaj nëse keni në këtë kohë apo keni pasur më heret statusin e DACA-s. Dokumenti i lejes së punës, edhe nëse ka skaduar ky document do të pranohet si dëshmi e statusit tuaj.

3. Ndihma për ju është e ofruar në disa gjuhë.

- Përfaqësuesit që u përgjigjen telefonatave tuaja flasin disa gjuhë. Nëse ata nuk e flasin gjuhën tuaj, ata e gjejnë një përkthyes.
- Ne i kemi trajnuar ndihmësit tanë në komunitet të cilët flasin gjuhën tuaj. Nëse dëshironi, ata mund të vijnë edhe tek vendi ku ju banoni ose punoni.

4. Informacionin që na jepni neve nuk do të shpërndalet.

- Atë që i thua ndihmësit të Sigurimi Shëndetësor të Shtetit të Nju Jorkut është private.
- Informacionin që na jepni neve për t'u regjistruar në Sigurimin Shëndetësor nuk do t'i jepet askujt tjetër dhe nuk do të përdoret për qëllime të tjera.

Rreth Sigurimit Shëndetësor të Nju Jorkut

Nju Jorku e ka hapur kompaninë e vet të Sigurimit Shëndetësor "Marketplace". (NY State of Health-Shërbimi shëndetësor i Shtetit të Nju Jorkut) në tetor të vitit 2013. Eksperienca e blerjes së sigurimeve shëndetësore me një ndalesë te Marketplace ofron plane shëndetësore gjithëpërfshirëse me cilësi të lartë. Sigurimi Shëndetësor i Shtetit të Nju Jorkut (NY State Health) është i vetmi vend ku konsumatorët mund të kualifikohen për të marrë ndihmë duke paguar për mbulim nëpërmjet zbritjeve premium ose kredive tatimore. Njujorkezët e kualifikuar gjithashtu mund të regjistrohen në Medicaid (Sigurimi Shëndetësor i paguar nga shteti), Child Health Plus (Sigurimi shëndetësor për fëmijët i paguar nga shteti) dhe Plani thelbësor përmes Marketplace gjatë gjithë vitit. Për më shumë informacion rreth Marketplace të shtetit të Nju, ju lutemi vizitoni: <https://nystateofhealth.ny.gov> ose telefononi Shërbimin e Klientit në 1-855-355-5777, TTY: 1-800-662-1220 ose gjëni një ndihmës regjistrimi.